



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 201 Prot

Datë 24. 01 .2025

P/VENDIM

Nr. 03 Date 24.01.25

Per percaktimin e çmimit te qirase mesatare te njesive te banimit dhe apartamenteve ne treg, per efekt te subvencionimit te qirase ne Bashkine Fushe-Arrez per vitin 2025.

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", VKM Nr.362 dt 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr.459, dt 3.7.2019 "Për regullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin".

Referuar ofertave të marra në treg për cmimin e qirave në qytetin Fushë-Arrëz dhe rrethina për vitin kalendarik 2024, për vitin 2025:

VENDOSI :

1. Miratimin e çmimit mesatar të qirave të banesave për efekt subvencionimi të qirasë sipas strukturës:
 - a) Për apartment të tipit "Garsionere" - 7000 lek/muaj.
 - b) Për apartment të tipit 1+1 - 12000 lek/muaj.
 - c) Për apartment të tipit 2+1 - 15000 lek /muaj.
 - d) Për apartment të tipit 3+1 - 23000 lek/muaj.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale ne Bashkine Fushe-Arrez dhe Komisioni i Strehimit Social te ngritur me urdher te Kryetarit te Bashkise, Zyra Juridike dhe Zyra e Finances
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zyra e Shërbimeve Sociale
Sidorela Katroshi

Kryetari i Bashkise
Hil CURRI



Zyra Juridike
Redona Hasani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Nr. 201/1 Prot

Datë 24. 01 .2025

RELACION

Mbi Projektvendimin

“Per percaktimin e cmimit te qirase mesatare te njesive te banimit dhe apartamenteve ne treg, per efekt te subvencionimit te qirase ne Bashkine Fushe-Arrez per vitin 2025.”

Me objekt: “Përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Fushë-Arrëz për vitin 2025”. Ne zbatim të ligjit Nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM Nr.459 dt 03.07.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyren e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKM Nr.362 dt 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyren e llogaritjes së tij” pika 4a e këtij vendimi: Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vleren konkrete të subvencionimit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në vleren mesatare të qirave e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale.

Prandaj lind nevoja e miratimit të një vendimi të Këshillit Bashkiak për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve të banimit në treg, për efekt të zbatimit të programit subvencionim i qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, masë e cila llogaritet në varësi të çmimit mesatar të qirasë në treg.

Ky nivel çmimesh miratuar në këtë vendim është arritur në përfundimin referuar ofertave të marra në treg për çmimin e qirave të apartamenteve në qytetin Fushë-Arrëz dhe periferi për vitin kalendarik 2024 si dhe kontratave noteriale qiraje të shoqëruara me kërkesën për strehimin social nga programi i subvencionimit të qirasë.

Zyra e Shërbimeve Sociale
Drejtoreshe
Sidorela Katroshi

Kryetari i Bashkise
Hil CURRI



Zyra Juridike
Redona Hasani